


korrik 2017

gap | analizë

Ndarja e subvencioneve nga komunat e ministritë

Baza ligjore, transparencë dhe llogaridhënia



Përmbledhje ekzekutive

Njëra ndër kategoritë më problematike të shpenzimit të parasë publike në Kosovë është ajo e subvencioneve, e cila në vitin 2016 përbënte 26.9% të buxhetit të shtetit. Subvencionet janë një formë e ndihmës financiare, në formë të të hollave apo të reduktimit të taksave, që jepen nga organizatat buxhetore për institucione, grupe njerëzish apo persona fizik.¹ Qëllimi i subvencioneve është lehtësimi i barrës financiare të ndonjë sektori të veçantë apo ofrimi i ndihmës shëndetësore dhe të mirëqenies sociale për personat në nevojë duke qenë në interes të përgjithshëm të publikut.

Përmes ndarjes së subvencioneve dhe transfereve në mënyrë efikase, duke targetuar sektorët apo shtresat në nevojë, qeveria mund të ndihmojë në rritjen e konkurrueshmërisë së sektorëve dhe uljen e shkallës së papunësisë. Andaj, përdorimi i subvencioneve si mjet rishpërndarës mund të jetë mjaft efektiv nëse bëhet si duhet.²

Por, edhe pse gati një e treta e buxhetit të shtetit shpenzohet në formë të subvencioneve, në Kosovë nuk ka pasur përparim në zhvillimin e kapaciteteve institucionale për të kontrolluar këtë ndihmë shtetërore. Sipas Raportit të Komisionit Evropian, subvencionet ende ofrohen pa një strategji dhe vlerësim të duhur.³ Kjo përgatit terrenin për 'kalorësit e lirë', pra personat që keqpërdorin subvencionet edhe kur janë në gjendje të krijojnë të ardhura në mënyra të tjera duke dëmtuar drejtpërdrejtë apo tërthorazi mundësinë e investimit të këtyre mjeteve në një aktivitet fitimprurës.

Hulumtimi është fokusuar në dy ministri, Ministria e Integritimit Evropian (MIE) dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK); si dhe në shtatë komuna: Gjakovë, Kamenicë, Ferizaj, Graçanicë, Obiliq, Malishevë dhe Prishtinë. Mostra e komunave përfaqëson shtatë parti të ndryshme që udhëheqin me qeverisjen lokale si dhe komunitete të ndryshme etnike.

¹Shembull: Subvencionim me anë të reduktimit të taksave mund të konsiderohet lirimi i një grupi të qytetarëve nga pagesa e tatimit në të ardhura deri në një prag të caktuar, për shembull ata që fitojnë deri në 3000 euro në vit. Kjo mund të bëhet përmes ndryshimit të politikave fiskale për mbledhjen e tatimit në të ardhura.

²Fondi Monetar Ndërkombëtar, Gerd Shwartz dhe Benedict Clemens "Subvencionet qeveritare" <<http://bit.ly/2h4rHtk>>

³ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2016, fq. 37 <<http://bit.ly/2INRFCl>>

Procedurat për ndarjen e subvencioneve

Në Kosovë nuk ka legjislacion standard për të gjitha organizatat buxhetore që rregullon kriteret e dhënies së subvencioneve. Tani për tani ekziston ligji për ndihmën shtetërore⁴ dhe rishtazi u krijua edhe rregullorja mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për kategorinë e OJQ-ve nga Ministria e Financave (MF)⁵, mirëpo i pari ende nuk është kompletuar me akte nënligjore dhe e dyta përjashton kategoritë tjera siç janë entitetet publike, ato private dhe personat fizik.

Institucionet që ndajnë subvencione për kategori të ndryshme, kulturë, art, rini, sport, mirëqenie sociale, shëndetësi e të tjera e bëjnë këtë duke u mbështetur në rregulloret e tyre të brendshme. Kështu, komunat e përzgjedhura për këtë hulumtim kanë rregullore të brendshme për ndarjen e subvencioneve, të cilat kanë bazë ligjore në Ligjin për vetëqeverisje lokale.⁶ Kamenica dhe Ferizaji i kanë miratuar rregulloret në vitin 2012⁷, Graçanica në vitin 2013⁸, Obiliqi në vitin 2014⁹, Malisheva në vitin 2015¹⁰, ndërkaq Prishtina dhe Gjakova kanë ndryshuar dhe plotësuar rregulloret më 2014¹¹, respektivisht 2015.¹²

Përmbajtjet e rregulloreve të komunave dhe ministrive janë të ndryshme ku disa prej tyre janë më të detajuara për sa i përket procedurave të shpalljes së thirrjes e deri tek raportimi i përfituesve të subvencioneve.

⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 05/L-100 për ndihmën shtetërore <<http://bit.ly/2vB0mlO>>

⁵ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Rregullore MF - nr - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve <<http://bit.ly/2ulNcS3>>

⁶ Neni 12 i Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale u jep kuvendëve komunale të drejtën e krijimit të akteve brenda fushës së kompetencave të tyre, përfshirë këtu edhe rregulloret komunale.

⁷ Komuna e Kamenicës, Rregullore për ndarjen e subvencioneve 2012 <<http://bit.ly/2vR6llw>>, hapur më 10 mars 2017 dhe Komuna e Ferizajit, Rregullore për ndarjen e subvencioneve 2012 <<http://bit.ly/2eH3kBb>>, hapur më 10 mars 2017

⁸ Komuna e Graçanicës, Rregullorja për ndarjen e subvencioneve 2013 <<http://bit.ly/2h1Yq2f>>, hapur më 10 mars 2017

⁹ Komuna e Obiliqit, Rregullorja për ndarjen e subvencioneve 2014 <<http://bit.ly/2vQQ14t>>, hapur më 10 mars 2017

¹⁰ Komuna e Malishevës, Rregullore për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve 2015 <<http://bit.ly/2uYklZe>>, hapur më 10 mars 2017

¹¹ Komuna e Prishtinës, Vendim për kriteret dhe procedurën e ndarjes së subvencioneve 2014 <<http://bit.ly/2uPa1aH>>, hapur më 10 mars 2017

¹² Komuna e Gjakovës, Rregullore për plotësim ndryshimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve 2015 <<http://bit.ly/2eH7qZW>> dhe <<http://bit.ly/2tsBTxr>>, hapur më 10 mars 2017

Ministria e Integrimit Evropian (MIE) ka rregullore për subvencionimin e OJQ-ve që kanë projekte për promovimin e integrimit evropian dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) ka rregullore për financimin e projekteve të OJQ-ve për zhvillimin dhe fuqizimin e komuniteteve. MIE ka miratuar rregulloren në vitin 2015, ndërsa MKK në vitin 2012.

Dallimet ndërmjet rregulloreve vërehen duke filluar nga vetë përkufizimi i termit “subvencion”. Në rregulloren e Komunës së Gjakovës flitet për “subvencione/transfere”, në rregulloret e komunave të Kamenicës, Malishevës, Graçanicës, Ferizajit dhe Obiliqit flitet për “ndihmë momentale”, kurse rregullorja e komunës së Prishtinës si dhe e MKK-së nuk definojnë asnjë term të ndërlidhur.

TABELA 1. DEFINICIONET E SUBVENCIONEVE SIPAS RREGULLOREVE

Termi	Definicioni
Subvencionet/Transferet (Gjakovë)	Pagesa financiare të njëhershme, të cilat i ndahen personit juridik apo fizik nga buxheti i Komunës së Gjakovës.
Ndihmë momentale (Kamenicë, Malishevë dhe Obiliq)	Ndihma e menjëhershme në para të gatshme që propozohet nga komisioni përkatës i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës dhe të miratuar nga ai.
Ndihmë momentale (Graçanicë dhe Ferizaj)	Ndihma e menjëhershme financiare në para të gatshme që propozohet nga zyrtarët autorizues të programeve pas shqyrtimit të kërkesave dhe më pas miratimit të tyre nga Kryetari i Komunës dhe Kuvendi Komunal.
Kërkesë për subvencion (Ministria e Integrimit Evropian)	Aplikacioni dhe dokumentet e bashkëlidhura me subvencion.
Komuna e Prishtinës dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim	Nuk ka definicion.

Burimi: Rregulloret e brendshme të institucioneve të përzgjedhura për hulumtim

Institucionet dallojnë edhe sa i përket procedurave për aplikim për përfitim të subvencioneve. Në Gjakovë, kërkesa i drejtohet komisionit për shqyrtim, kryetar-it/es, apo drejtorive përkatëse të komunës, varësisht kush e ka shpallur thirrjen. Në Kamenicë, Graçanicë, Ferizaj, Malishevë dhe Obiliq, kërkesat i drejtohen kryetarëve të komunave. Në Prishtinë, kërkesat i drejtohen drejtorive përkatëse duke plotësuar formularë të veçantë. Ndonëse procedurat për aplikim janë përcaktuar me rregullore, gjatë hulumtimit kemi hasur në raste kur komunat kanë dhënë subvencione për kryerjen e shërbimeve, por nuk kanë publikuar thirrje për marrjen e ofertave duke dëmtuar konkurrencën në treg, siç diskutohet në rastin e Graçanicës tek pjesa e shkeljeve të evidentuara.

Ndërkaq sa i përket ministrive, MIE nuk përcakton përmes kujt dorëzohen aplikacionet, por vetëm se çfarë duhet dorëzuar, kurse tek MKK, është Departamenti për planifikimin e politikave dhe analizave që përpilon kriteret e projekteve dhe pranon kërkesat për subvencionim.

Secili institucion parasheh edhe formimin e komisioneve për ndarjen e subvencioneve. Por, roli i komisioneve është i kufizuar vetëm në vlerësimin e kërkesave dhe propozimin e përfituesve. Në fund, miratimi bie nën përgjegjësinë e kryetar-it/es apo ministr-it/es. Përbërja e komisioneve në disa raste parashihet të bëhet sipas ekspertizës në fushën e caktuar, duke kombinuar ekspertë të brendshëm të institucionit me të angazhuar nga jashtë. Nuk ka ndonjë kriter ligjor për përbërjen gjinore të komisioneve vlerësuese.

Rregulloret e komunave së Gjakovës dhe Obiliqit parashohin krijimin e komisioneve nga drejtoritë përkatëse për fushën e bujqësisë, arsimit dhe shëndetësisë e mirëqenies sociale. Rregulloret e komunave së Kamenicës dhe Graçanicës cekin vetëm formimin e komisionit për ndarjen e subvencioneve për persona fizik në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, në kuadër të drejtorive përkatëse. Në rregulloren e Komunës së Ferizajt vetëm ceket se shuma e ndihmës propozohet nga komisionet, por pa dhënë detaje për përbërjen e komisionit. Ndërkaq, në rregulloren e Komunës së Malishevës thuhet se komisioni formohet nga Kryetar-i/ja i/e Komunës dhe përbëhet nga zyrtarë të komunës. Vetëm në rregulloren e plotësuar të Komunës së Prishtinës parashihet që komisioni të përbëhet nga drejtoria përkatëse, ekspertë të jashtëm dhe shoqëria civile, gjë që mundëson gjykim më të drejtë dhe më transparent të projekteve përfituese apo të personave dhe familjeve në nevojë.

Sa i përket ministrive, komisionet formohen nga Sekretarët e Përgjithshëm të ministrive përkatëse dhe përbëhen nga tre anëtarë të cilët vlerësojnë kërkesat dhe përgatisin raportet për dorëzim. Sikurse në rastin e komunave, edhe komisionet brenda ministrive dërgojnë raportet për miratim tek ministrat.¹³ Por ka raste kur ministrat nuk i respektojnë rekomandimet e komisioneve. Në vitin 2014, ministrja e MIE ka marrë vendim në kundërshtim me propozimin e komisionit, duke subvencionuar pesë projekte të refuzuara nga komisioni vlerësues për

¹³ Ministria e Integritimit Evropian, Rregullore nr. 01/2015 MIE për subvencionim të projekteve të OJQ-ve që promovojnë procesin e integritetit Evropian në Republikën e Kosovës 2015 <<http://bit.ly/2upmYHj>>, hapur më 10 mars 2017

Ministria për Komunitete dhe Kthim, Rregullore për subvencionim të projekteve të OJQ-ve për zhvillimin dhe stabilizimin e komuniteteve 2015 <<http://bit.ly/2tDCdh1>>, hapur më 10 mars 2017

arsye se nuk bënin pjesë në kategorinë e projekteve të parapara për subvenciom me rregulloren e ministrisë.¹⁴

Dallimet ndërmjet institucioneve vërehen edhe në aspektin e periudhës kohore për shpalljen e thirrjeve për subvencione dhe kohën e paraparë për shqyrtimin e kërkesave. Kështu, Komuna e Prishtinës shqyrton kërkesat së paku një herë në 90 ditë.¹⁵ Ngjashëm vepron edhe Komuna e Obiliqit, ku shqyrtimet e kërkesave për subvencione për shëndetësi dhe mirëqenie sociale bëhen katër herë në vit, ani pse në rregullore ceket vetëm afati 15 ditor që kryetar-i/ja i jep drejtorisë për të dhënë mendim profesional për ndarjen e subvencioneve.¹⁶ Në komunat e Kamenicës dhe Malishevës, afati për shqyrtimin e kërkesave është 15 ditë¹⁷, ndërsa në komunat e Graçanicës dhe Ferizajt, është 30 ditë, ku në këto raste iu referohen vetëm subvencioneve për shëndetësi dhe ndihmë sociale.¹⁸ Rregulloret e institucioneve të tjera nuk kanë përcaktuar afat për shqyrtimin e kërkesave.

Afati për shqyrtim të ankesave dhe legjitimiteti i ankesave nuk përmenden në asnjë rregullore, me përjashtim në Komunën e Gjakovës, ku ceket se ankesat për ndarjen e bursave shqyrtohen në afat prej 15 ditësh. Megjithatë, për arsye se në shumicën e institucioneve ndarja e bursave rregullohet me akte nënligjore të veçanta, në këtë hulumtim nuk jemi fokusuar në ndarjen e bursave si kategori e subvencioneve.

Kufiri i shumës së subvencioneve dhe numrit të përfitimeve nga subjekti i njejtë

Në nivelin lokal, përveç Prishtinës, secila komunë ka kufijtë për shumën e subvencioneve për persona juridik dhe fizik. Përkundër faktit që Graçanica është komuna më e vogël dhe ka më së paku banorë në këtë mostër, ajo ka kufijtë më të lartë të subvencionimit në krahasim me

¹⁴ Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), Raporti i Auditimit për Raportin Financiar vjetor për Ministrinë e Integritimit Evropian për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014, fq. 20 <<http://bit.ly/2uwsyHO>>

¹⁵ Komuna e Prishtinës, Vendim për kriteret dhe procedurën e ndarjes së subvencioneve 2014, neni 11, fq. 3 <<http://bit.ly/2uPa1aH>>, hapur më 10 mars 2017

¹⁶ Intervistë me Mihane Mjekiqi, kryesuese e komisionit për ndarjen e subvencioneve për vitin 2016 në lëminë e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në Komunën e Obiliqit, realizuar më 30 qershor 2016 dhe Komuna e Obiliqit, Rregullorja për ndarjen e subvencioneve 2014, neni 5, fq. 3, <<http://bit.ly/2vQQ14t>>, hapur më 10 mars 2017

¹⁷ Komuna e Kamenicës, Rregullore për ndarjen e subvencioneve 2012, neni 12, fq. 7 <<http://bit.ly/2vR6llw>>, hapur më 10 mars 2017

Komuna e Malishevës, Rregullore për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve 2015, neni 12, fq. 6, <<http://bit.ly/2uYklZe>>, hapur më 10 mars 2017

¹⁸ Komuna e Graçanicës, Rregullorja për ndarjen e subvencioneve 2013, neni 20, fq.7 <<http://bit.ly/2h1Yq2f>>, hapur më 10 mars 2017

Komuna e Ferizajt, Rregullore për ndarjen e subvencioneve 2012, neni 20, fq.7 <<http://bit.ly/2eH3kBb>>, hapur më 10 mars 2017


së subvencioneve 2014 <<http://bit.ly/2uPa1aH>>, hapur më 10 mars 2017

komunat e tjera. Në Komunën e Graçanicës, personat juridik mund të përfitojnë subvencion deri në 30,000 euro, kurse personat fizik deri në 10,000 euro. Deri në këtë shumë, aprovimin e kërkesës e bën Kryetar-i/ja i/e Komunës, ndërkaq për çdo shumë më të lartë, vendos Komiteti për politika dhe financa i Kuvendit Komunal.

Komuna e Gjakovës, kufirin për persona juridik e ka 15,000 euro, e për persona fizik 3,000 euro. Vendimi merret njejtë sikurse në rastin e Graçanicës. Përjashtim kanë fushat e bujqësisë dhe arsimit (ndarja e bursave dhe mbështetja e nxënësve me nevoja të veçanta), të cilat subvencionohen me vendim të Kuvendit Komunal.

Gjithashtu, në komunat e Kamenicës, Malishevës, Ferizajt dhe Obiliqit janë të definuara shumat e përfitimeve që mund t'i ndajnë kryetarët e komunave dhe shumat që duhet të marrin aprovimin e kuvendit komunal. Kufijtë e subvencioneve të këtyre komunave, me përjashtim të Komunës së Ferizajt, nuk kanë dallim shumë të madh sa i përket llojit të përfituesit. E nga ministritë e përzgjedhura, MKK e ka të përcaktuar kufirin për subvencionimin e projekteve deri në 10,000 euro.

FIGURA 1. KUFIRI PËR PERSONA JURIDIK DHE FIZIK SIPAS RREGULLOREVE TË KOMUNAVE



BURIMI: RREGULLORET E BRENDSHME PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE TË KOMUNAVE TË PËRZGJEDHURA

Sa i përket kufizimit në përfitim nga i njëjti subjekt, vetëm rregulloret e komunave të Kamenicës, Malishevës, Obiliqit dhe Prishtinës parashohin se familjet dhe individët mund të përfitojnë vetëm një herë në vit, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme. Në nivel qendror, rregullorja e MKK-së cek se nuk përkrahen projektet të cilat vazhdojnë nga projektet e mëparshme të subvencionuara nga ministria.

Fushat që subvencionohen nga komunat

Fushat në të cilat ndahen subvencionet kanë të bëjnë me kulturë, sport, rini, bujqësi, zhvillim ekonomik, arsim, shoqëri civile, shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Ndërkaq sa i përket ndarjes së subvencioneve të ndërlidhura me programin qeverisës, vetëm Komuna e Gjakovës cek se kriteret janë të ndërlidhura me planin e punës së drejtorive të komunës, më konkretisht për projektet e rinisë dhe subvencionet për persona fizik.

Në fushën e kulturës ndahen subvencione që promovojnë vlera kulturore, dhe ndihmojnë barazinë gjinore dhe integrimin e grave dhe vajzave.

Në fushën e sportit, kriteret për subvencionim kanë të bëjnë me aktivitete të masovizimit të sportit, përfshirjes së të rinjëve dhe të rejave në sport, avancimin e klubeve sportive, implementimin e politikave zhvillimore afatshkurtëra, përkrahje për shoqatat e pedagogëve të kulturës fizike, e të tjera.

Sa i përket bujqësisë, subvencionet kryesisht ndahen për blegtori, perimtari, pemtari, pylltari, shpezëtari, bletari dhe mbjellje pranverore dhe vjeshtore. Kriteret për subvencionim në bujqësi nuk janë mirë të detajuara dhe të qarta nga asnjëra komunë e përfshirë në këtë hulumtim. Madje, Komuna e Malishevës nuk ka kriteret për subvencionim në bujqësi, kurse në Prishtinë janë si pjesë e zhvillimit ekonomik rural.

Këto paqartësi kanë kontribuar në ndarje të parregullt të subvencioneve për këtë kategori. Përfaqësues të komunave mendojnë se dhënia e subvencioneve nuk ka rezultuar me shtimin e prodhimit bujqësor dhe prandaj duhet ndërruar praktikat e deritanishme. Në vend se të perkrasohen fermerët për njësi të sipërfaqes të mbjellur me, për shembull, grurë, duhet ndarë subvencione për rendiment në menyrë që të stimulohet prodhimi dhe jo të subvencionohet njësoj fermerët që kanë prodhim të shtuar dhe fermerët që vetëm kanë të mbjellur sipërfaqe, por jo edhe shtim në prodhim. Ngjashëm, kur subvencionohet prodhimi i qumështit të konsiderohet si kriter sasia e qumështit e dërguar në qumështore dhe jo numri i bagëtisë.¹⁹

Ministria e Financave ka hartuar një rregullore mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve. Ndër dispozitat kryesore janë që financimi në para apo në forma të tjera të bëhet për projektet dhe programet që janë në përputhje me prioritetet e Kosovës dhe që kanë vlerë të shtuar në rritjen e cilësisë së jetës apo nxitjen e zhvillimit të komunitetit. Në rregullore poashtu parashihen shpalljet e thirrjeve, karakteri konkurrues, krijimi i komisioneve vlerësuese dhe të ankesave,

¹⁹ Komente nga përfaqësues të Drejtorisë së Bujqësisë të Komunës së Prishtinës pas tryezës së mbajtur për komentimin e draft analizës mbi ndarjen e subvencioneve

sigurimi i dy-shkallshëm në trajtimin e ankesave të aplikantëve si dhe parandalimi i financimit të subjekteve politike, e shumë dispozita të rëndësishme për efikasitetin e ndarjes së fondeve publike. Dispozitat e kësaj rregulloreje, megjithatë, nuk vlejnë për përkrahjen e programeve apo projekteve që kalojnë 5% të ndarjes totale buxhetore të programeve buxhetore deri në 100,000 euro, 2% të programeve buxhetore nga 100,001-1,000,000 euro dhe 1% të programeve buxhetore mbi 1,000,000 euro. Në këto raste parashihet krijimi i kontratave të veçanta.²⁰

Në praktikë, deri më tani subvencionimi i OJQ-ve kryesisht ndodh për organizimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me edukimin joformal, punësimin e të rinjve, fuqizimin e organizatave rinore përmes trajnimeve dhe kurseve për aftësim, integrimin e grupeve të marginalizuara dhe promovimin e vullnetarizmit. Subvencionimi në fushën e arsimit kryesisht bëhet duke ndarë bursa për nxënës dhe studentë, për trajnime, gara, promovime, e të ngjashme. Komuna e Prishtinës, Obiliqit dhe Malishevës kanë nxjerrë rregullore të veçanta për ndarjen e bursave. Në këto rregullore, këto komuna i specifikojnë kriteret për ndarje të bursave. Komuna e Ferizajit dhe Graçanicës nxjerrin vendime për ndarjen e bursave.

Subvencione për fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale shpesh jepen edhe nga zyrat e kryetarëve. Në rregulloret e miratuara nga komunat, këto subvencione kryesisht ndahen nga drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Për subvencionim nga kjo fushë kërkohet që të dëshmohet me anë të dokumenteve për gjendjen ekonomike, shpenzimet mjekësore apo fatkeqësitë natyrore. Në këtë fushë ndahen edhe ndihma momentale që miratohen nga kryetar-i/ja e komunës.

Kriteret për subvencionim nga ministritë janë shumë të përgjithësuara dhe kryesisht lidhen me aktivitetet e ministrive. MIE subvencionon projektet në lidhje me integrimin evropian dhe MKK subvencionon projektet në lidhje me riintegrim të komuniteteve; kthim të qëndrueshëm dhe promovim të dialogut, tolerancës dhe bashkëjetesës në Kosovë.

Përfitimi i subvencioneve, raportimi dhe ndëshkimi

Në rregulloret e shumicës së institucioneve nuk përmendet në mënyrë të qartë nënshkrimi i marrëveshjeve me përfituesit. Në praktikë, marrëveshjet në formë të memorandumit të mirëkuptimit nënshkruhen me drejtoritë përkatëse apo me ministritë. Megjithatë, të gjitha rregulloret cekin se çfarë dokumentesh u duhet bashkangjitur kërkesave për subvencione për projekte apo për ndihmë shëndetësore dhe sociale.

²⁰ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Rregullore MF - nr - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve <<http://bit.ly/2ulNcS3>>

Sa i përket transparencës rreth përfituesve të subvencioneve, në komunat e Kamenicës, Graçanicës, Ferizajt, Malishevës dhe Obiliqit, komisioni krijon listën e përfituesve potencialë para se ta dorëzojë te kryetar-i/ja për aprovim, por nuk ceket se duhet publikuar lista e përfituesve. Ndërkaq, MIE duhet të publikojë informatat kyçe mbi përfituesit dhe qëllimin dhe aktivitetet kryesore të projektit. Në Komunën e Prishtinës dhe MKK, publikimi i listave nuk përmendet.


Por, dukuri shqetësuese sipas përfaqësuesve të legjislativit është fakti që Ministria e Financave buxheton shuma të caktuara për kategorinë e subvencioneve duke ua ndarë të gjitha institucioneve shtetërore e të cilat më pas i shpenzojnë ato në projekte të paplanifikuara. Duke mos patur kapacitete të brendshme për t'i implementuar projektet, institucionet pastaj përdorin kategorinë e subvencioneve për të kontraktuar OJQ për implementimin e projekteve të ndryshme duke u mbuluar edhe shpenzimet operative. Përveç kësaj, në pjesën dërrmuese të shpenzimeve nuk ka raporte kthyes mbi përmbushjen e objektivave dhe progresin e arritur, pra nuk ka matje të performancës.²¹

Sa i përket kontrollit të shfrytëzimit të mjeteve, rregulloret e komunave të Gjakovës, Kamenicës, Graçanicës dhe Ferizajt cekin se për organizime të ndryshme duhet sjellur fatura, lista të pjesëmarrësve, dhe dëshmi të tjera sipas nevojës. Mirëpo, rregulloret nuk përcaktojnë afatin kohor gjatë të cilit përfituesit janë të obliguar të ofrojnë dëshmitë rreth shpenzimeve në lidhje me projektin apo rastin për të cilin u është ndarë subvencioni. Mungesa e një afati të tillë krijon hapësirë për keqpërdorim nga përfituesit e dy apo më shumë subvencioneve. Të dhënat e dërguara nga komunat tregojnë se ka raste kur përgjatë një viti kalendarik një individ apo shoqatë përfiton subvencione mbi 3-4 herë.

Sa i përket ndëshkimeve, në rregulloret e komunave të Kamenicës, Graçanicës dhe Ferizajt thuhet se nëse përfituesit nuk dëshmojnë shpenzimet, kryetarët e komunave kërkojnë kthimin e mjeteve përmes procedurave ligjore. Por, në asnjërën rregullore nuk parashihet ndonjë metodë e kontrollit të cilësisë përmes auditimeve apo vizitave.

Sa i përket nivelit qendror, në rregulloren e Ministrisë së Integritimit Evropian ceket se ministria mund të kërkojë në çfarëdo kohe raportim nga OJQ-të përfituese të cilat duhet ta dorëzojnë raportin brenda dhjetë ditëve. Ndërkaq, pas përfundimit të projektit, përfituesit obligohen të dorëzojnë raportet financiare, narrative dhe tabelare, brenda 30 ditësh. Në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, Komisioni për monitorimin e implementimit të projektit kërkon raporte financiare dhe narrative, mujore dhe tre mujore. Në rast të mashtrimeve apo shkeljeve, përfituesit

²¹ Komente nga përfaqësues të Kuvendit të Republikës së Kosovës pas tryezës së mbajtur për komentimin e draft analizës mbi ndarjen e subvencioneve



nga MIE ndalohen nga subvencionimi për katër vite dhe i nënshtrohen dispozitave ligjore sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Në raste të ngjashme, MKK-ja ndërpreu marrëveshjen dhe mund të iniciojë procedura gjyqësore kundrejt shkelësve.


TABELA 3. MATRICA E RREGULLOREVE TË KOMUNAVE DHE MINISTRIVE

	Gjakovë	Kamenicë	Graçanicë	Ferizaj	Malishevë	Obiliq	Prishtinë	MIE	MKK
Muaji i miratimit të rregullores	5		3	9	9	7	5	6	3
Viti i hyrjes në fuqi	2015	2012	2013	2012	2015	2014	2014	2015	2012
Ligji për vetqeverisje lokale	x	x	x	x	x	x	x	Rregullore nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së KM dhe Ministrive	Neni 58 i Kushtetutës së Kosovës; Ligji nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të RKS; Rregullore nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së KM dhe Ministrive; etj.
Definicioni i subvencionit	x	x			x	x		x	
Dërgimi i kërkesës	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Afatet për shqyrtim jashtë thirrjes		x	x	x	x	x			
Afatet për shqyrtim brenda thirrjes							x		
Afatet për shqyrtim të ankesave	x								
Komisioni për vlerësim	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Plotfuqishmëria e komisionit vlerësues	x	x	x	x	x	x		x	x
Marrëveshje në mes të institucionit dhe përfituesit	x							x	x
Raportimi nga përfituesit (fatura, lista)		x	x	x				x	x
Penalizimet		x	x	x				x	x
Regjistri i përfituesve/kërkesave	x	x	x	x	x	x		x	
Çështja e transparencës-publikimit në ëeb								x	
Procesverbalet									
Barazia gjinore në komisione									
Banka pagesa (mënyra e pagesës)									
Obligimi për shpallje	x					x	x		
Kufiri për persona juridik	x 15,000 EUR	x 2,000 EUR	x 30,000 EUR	x 10,000 EUR	x 1,000 EUR	x 1,500 EUR	x nuk ka limit		x 10,000 EUR
Kufiri për persona fizik	x 3000 EUR	x 1,200 EUR	x 10,000 EUR	x 1,000 EUR	x 500 EUR	x 1,000 EUR	x nuk ka limit		
Lidhja e kriterëve me programin qeverisës	x						x		
Kriteret sektoriale	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Kriteret për persona fizikë	x	x	x	x	x	x	x		
Kriteret për biznese	x						x		
Kufizimet në numrin e përfitimeve nga i njejt i subjekt		x				x	x		x

Shpenzimet për subvencione

Sipas raporteve financiare të audituara nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016, në komunat e përzgjedhura janë ndarë subvencione me shuma të ndryshme (shih figurën 2).²² Mirëpo në proporcion me buxhetin total, Graçanica ndan rreth 4.6% të buxhetit për subvencione, kurse Prishtina si kryeqytet shpenzon rreth një pikë përqindjeje më pak. Komunat e tjera shpenzojnë më së paku 0.7% dhe më së shumti 2.6% të buxhetit total për subvencione. Asnjëra nga komunat nuk ka tejkaluar buxhetin final për shpenzimet e subvencioneve.

FIGURA 2. SUBVENCIONET E DHËNA NË NIVEL LOKAL PËR MOSTRËN E PËRZGJEDHUR NË VITIN 2016




Burimi: Raportet e auditimit të pasqyrave financiare të komunave të përzgjedhura për vitin 2016, Zyra Kombëtare e Auditimit

Ministria e Integritimit Evropian dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim kanë shpenzuar 100% të buxhetit të shpenzimeve. Pjesëmarrja e shpenzimeve të subvencioneve në buxhetin total të MIE-së ishte rreth 10.6%, ndërsa e MKK-së rreth 3.9%.²³

²² Komunat e përzgjedhura, Raportet për ndarjen e subvencioneve nga komunat e përzgjedhura 2016

²³ Ministrinë e përzgjedhura, Raportet për ndarjen e subvencioneve nga ministrinë e përzgjedhura 2016

FIGURA 3. SUBVENCIONET E DHËNA NË NIVEL QENDROR PËR MOSTRËN E PËRZGJEDHUR NË VITIN 2016



Burimi: Raportet e auditimit të pasqyrave financiare të ministrive të përzgjedhura për vitin 2016, Zyra Kombëtare e Auditimit

Përmes zyrës së kryetar-it/es apo administratës, siç kategorizohet në disa komuna, janë dhënë rreth 7% të subvencioneve në Gjakovë, 45% në Kamenicë, 74% në Graçanicë, 7% në Ferizaj, 72% në Malishevë, 15% në Obiliq dhe 16% në Prishtinë. Dhënia në shuma të larta përmes zyrës së kryetar-it/es krijon hapësirë për dhënie të subvencioneve pa kriterë përmes fushave të caktuara, e në dy raste më lartë shohim se mbi 50% e subvencioneve janë dhënë përmes kësaj kategorie, për të cilën nuk parashihet ndonjë kriter në rregullore. Kjo mund të çojë në favorizim të institucioneve apo individëve pa shkelur rregulloren. Prandaj është jetike që rregulloret të përmbajnë edhe dispozita rreth subvencioneve që lejohet të jepen përmes zyrës së kryetar-it/es dhe drejtorive tjera me kriterë të qarta.

Shkeljet e evidentuara në ndarjen e subvencioneve

Edhe pse rregulloret përcaktojnë kufijtë maksimalë për shumatat e subvencioneve dhe ndalojnë përfitimin e shumëfishtë të subvencioneve nga i njëjti subjekt brenda një viti, raportet e auditimit kanë gjetur shkelje të kësaj natyre.

Në Komunën e Gjakovës, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka dhënë vërejtje për monitorimin e dobët të raportimeve financiare nga përfituesit. Kur Kuvendi Komunal kishte ndarë 200 mijë euro subvencione, mbi limitin e përcaktuar me rregullore, për revitalizim të ngrohtores së Gjakovës, komuna nuk kishte ndonjë raport që do të konfirmonte se fondet e dhëna janë shfrytëzuar sipas destinimit të

përcaktuar.²⁴ Edhe në analizën tonë mbi të dhënat e përfituesve, del se Gjakova ka kaluar shumën e kufijve edhe në tri raste të tjera, ku për njërin rast, ndihma për NTP “Fatoni”, komuna ka kaluar kufirin për 25 mijë euro.

Komuna e Kamenicës në 14 raste, gjatë vitit 2016, ka dhënë shuma më të mëdha të subvencioneve duke tejkeluar kufirin për më shumë se 1,000 euro për persona fizik e 3,000 euro për persona juridik. Edhe pse ligjore, dhënia e subvencioneve mbi kufirin e lejuar për 14 përfitues mund të sinjalizojë nevojën për ndryshimin e rregullores duke rritur kufijtë për dhënien e subvencioneve me miratim nga kryetari. Gjithashtu, me Rregulloren e Komunës së Kamenicës nuk lejohet subvencionimi i një subjekti më shumë se një herë në vit. Kurse në listën e përfituesve shohim të njëjtit emra, pagesat e të cilëve janë bërë në muaj të ndryshëm gjatë vitit. Për shembull, OJQ Fortesa dhe Handikos Kamenicë, kanë marrë subvencione nga dy herë në vit, si dhe kanë marrë subvencione në shuma mbi 2,000 euro me miratim të kryetarit të komunës, edhe pse kufiri maksimal i lejuar është 2,000 euro.²⁵

Në Komunën e Graçanicës, ZKA ka gjetur disa parregullësi ku janë paguar shërbimet e transportit për studentë të territorit të Graçanicës por edhe të Mitrovicës në kuadër të marrëveshjes me një organizatë jo-qeveritare. Në këtë rast nuk është evidentuar përzgjedhja e kryesit të shërbimeve dhe nuk është siguruar që çmimi për kryerjen e shërbimeve është sipas çmimit të tregut. Po ashtu, në një rast komuna ka paguar një biznes individual për punëtorët, ushqimin, pijet dhe shpenzimet e veterinarit që bie ndesh me rregulloren e brendshme e cila nuk parasheh mbështetje për biznese.²⁶ Edhe sipas listës së përfituesve, në Graçanicë ka përfitues të njëjtë disa herë brenda vitit që paraqet shqetësim për favorizim të përfituesve të njëjtë, përkundër faktit që në rregullore nuk përcaktohet numri i herëve që i njëjti subjekt mund të merr subvencione nga komuna. Për shembull Këshilli Rinor i Graçanicës (OCD) dhe Organizata e Turizimit të Graçanicës (TOG) kanë marrë subvencione nga shtatë herë brenda vitit duke akumuluar një shumë totale afro 14 mijë euro dhe 51 mijë euro respektivisht.²⁷

Në Komunën e Ferizajit, ZKA kishte gjetur keqklasifikim të shpenzimeve duke vendosur pagesat për furnizimin e fermerëve me fidanë të

²⁴ Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), Raporti i Auditimit për Raportin Financiar vjetor për Komunën e Gjakovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, fq. 22 <<http://bit.ly/2slx9aM>>

²⁵ Këta shembuj janë marrë nga lista e përfituesve të subvencioneve të pranuar nga Komuna e Kamenicës, sipas kërkesës së Institutit GAP.

²⁶ Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), Raporti i Auditimit për Raportin Financiar vjetor për Komunën e Graçanicës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, fq. 22 <<http://bit.ly/2ssS6SM>>

²⁷ Këta shembuj janë marrë nga lista e përfituesve të subvencioneve të pranuar nga Komuna e Graçanicës

mjedrave dhe të sistemit të ujitjes në kategorinë e subvencioneve, të cilat është dashur të vendosen në kategorinë e transfereve kapitale, gabim i cili rezulton me prezentim jo të vërtetë të shpenzimeve për kategori.²⁸ Gjithashtu edhe në rastin e Ferizajit, vërehet tendenca e përfituesve të shumifshhtë, ku për shembull Shoqata e Artistëve Figurativ “Zef Kolombo” ka përfituar pesë herë me një shumë totale prej rreth nëntë mijë euro.²⁹

Në Komunën e Malishevës, ZKA kishte gjetur miratim të subvencioneve më të larta se sa lejohet sipas rregullores nga kryetari pa i dërguar ato subvencione për miratim në Kuvendin Komunal duke rrezikuar kështu transparencën në ndarjen e subvencioneve.³⁰ Komuna e Malishevës poashtu ka ndarë dy herë subvencione për shoqatën e grave Fatjona gjatë vitit 2016, ani pse rregullorja e saj ndalon subvencionimin e një subjekti më shumë se një herë në vit.³¹

Komuna e Obiliqit ka ndarë subvencione gjatë vitit 2016 për tri biznese siç është vërtetuar në listën e përfituesve nga kjo komunë, përkundër asaj që me rregulloren e brendshme nuk parashihet subvencionim i subjekteve profitabile e private. Kjo nënkuptohet nga prapashtesa sh.p.k (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) që dikton llojin e kompanisë. Këto kompani ishin Fresh Fruit Pr, Mitrix Culture dhe Alfa Com, ku dy të parat ishin subvencionuar nga tri herë brenda vitit duke akumuluar subvencione prej rreth 25 mijë euro dhe 1,500 euro respektivisht, që përbën edhe një tjetër shkelje të rregullores, e cila nuk lejon subvencionim të të njëjtit subjekt më shumë se një herë në vit.³²

Përfaqësues të komunës së Obiliqit shpjegojnë se bashkëpunimi me Mitrix Culture ka pasur për qëllim përkrahjen e të rinjëve në fushën e aktrimit dhe vlera totale e subvencionit ishte 1,500 euro, por është dashur të ndahet në tri pjesë dhe të ipet nga tri linja buxhetore për shkak të limiteve buxhetore.³³ Megjithatë, ky rast tregon mosplanifikim të mirë të buxhetit duke u përkrahur rinia edhe me nga një pjesë të

²⁸ Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), Raporti i Auditimit për Raportin Financiar vjetor për Komunën e Ferizajit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, fq. 27 <<http://bit.ly/2spjfkS>>

²⁹ Këto shembuj janë marrë nga lista e përfituesve të subvencioneve të pranuar nga Komuna e Ferizajit

³⁰ Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), Raporti i Auditimit për Raportin Financiar vjetor për Komunën e Malishevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016 fq. 19 <<http://bit.ly/2tjlo8n>>

³¹ Këta shembuj janë marrë nga lista e përfituesve të subvencioneve të pranuar nga Komuna e Malishevës

³² Këta shembuj janë marrë nga lista e përfituesve të subvencioneve të pranuar nga Komuna e Obiliqit

³³ Komente nga përfaqësues të Komunës së Obiliqit pas tryezës së mbajtur për komentimin e draft analizës mbi ndarjen e subvencioneve

subvencionit nga drejtoria e bujqësisë dhe e asaj për ekonomi, financa e zhvillim që nuk përshtatet me objektivat e tyre.

Pagesa për rastin e kompanisë Alfa Com është stonuar për shkak se komuna ka bërë pagesën gabimisht. Ndërsa, rasti i Fresh Fruit Pr ka të bëjë më përfitimin e mjedrave nga fermerët të cilat pastaj shiten përmes kësaj kompanie dhe pagesa është bërë dy herë për arsye sezonale të zhvillimit të rendimentit.³⁴

Në Komunën e Prishtinës, ZKA kishte gjetur probleme të ngjashme me atë të Gjakovës ku për dy raste – atë të subvencionimit të festës së muzikës “21 Qershori” dhe të drejtorisë artistike të teatrit mimik, kanë munguar dëshmi financiare e narrative se mjetet e ndara janë shpenzuar për qëllimin e caktuar duke krijuar rrezik për mungesë të përgjegjësisë nga shpenzimi i drejtë i fondeve të drejtorive e programeve të caktuara.³⁵ Komuna e Prishtinës është e vetmja nga komunat që nuk ka përcaktuar kufijtë për ndarjen e subvencioneve me miratim nga kryetari, por e ka të përcaktuar përfitimin e kufizuar për vit nga një individ apo institucion. Sipas listës së përfituesve edhe në Prishtinë në disa raste i’u është dhënë subvencione personave të njejtë, dy raste personave fizik dhe një rast OJQ Oda, e cila kishte përfituar dy herë nga 2,500 euro.³⁶

Edhe në Ministrinë e Integritimit Evropian (MIE) dhe Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK) janë gjetur keqmenaxhime me subvencione nga ZKA. Në MIE, në tri raste, përfituesit nuk kishin ofruar arsyetimin me dëshmi relevante si dhe nuk ishte përcaktuar me marrëveshje koha kur duhen realizuar projektet. MIE-së i mungon edhe baza ligjore për të kërkuar dëshmi rreth realizimit të projektit duke rrezikuar keqpërdorimin e mjeteve nga përfituesit.³⁷ Sipas listës së përfituesve, MIE ka ndarë fonde dy herë për të njejtën OJQ “Neë Opportunities on Education” me nga tre mijë euro.

Sa i përket MKK-së, komisioni vlerësues për subvencionimin e një OJQ,- kishte deklaruar se i ka plotësuar kushtet, por Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka gjetur se kjo OJQ nuk kishte plotësuar kriterin për krijimin e një buxheti në të cilin specifikohen të gjitha aktivitetet dhe çmimi i tyre. Në një tjetër rast, përfituesi nuk ka ofruar dëshmi shtesë për përdorimin e subvencioneve përpos raportit financiar, dhe në rastin tjetër, MKK ka blerë mobilje për familjet në nevojë edhe pse ishte në kundërshtim me

³⁴ Ibid.

³⁵ Këta shembuj janë marrë nga lista e përfituesve të subvencioneve të pranuar nga Komuna e Prishtinës

³⁶ Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA)

³⁷ Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), Raporti i Auditimit për Raportin Financiar vjetor për Ministrinë e Integritimit Evropian për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, fq. 16 <<http://bit.ly/2tkfTY5>>

rregulloren e brendshme.³⁸ MKK nuk ka subvencionuar më shumë se një herë askë, por përmes kategorisë së subvencioneve ka bërë transport për të zhvendosurit në Zoçishte dhe Gjakovë me nga afro 1,500 e 3,000 euro.

³⁸ Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), Raporti i Auditimit për Raportin Financiar vjetor për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, fq. 20 <<http://bit.ly/2tjPnOL>>

Përfundime dhe rekomandime

Ligji për vetëqeverisje lokale u jep kuvendëve komunale të drejtën e krijimit të akteve brenda fushës së kompetencave të tyre, përfshirë këtu edhe rregulloret komunale.³⁹ Si rrjedhojë, ndarja e subvencioneve është e rregulluar përmes rregulloreve të brendshme të komunave. Mirëpo, sipas ligjit për vetëqeverisje lokale “të gjitha aktet komunale duhet të jenë në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës.” Andaj, mos inkorporimi i kriterëve bazike në këto rregullore, sikurse ai për mos shtrembërim të konkurrencës përmes subvencioneve, është në shpërputhje me ligjet aktuale relevante (shih ligjin për ndihmën shtetërore).

Ky raport i Institutit GAP nxjerr në pah disa nga probleme kryesore që kanë të bëjnë me përmbajtjen dhe zbatimin e rregulloreve të komunave për subvencionet. Disa nga problemet kryesore me rregulloret janë mungesa e përkufizimit të subvencioneve apo përkufizimi i ndryshëm përmes rregulloreve të komunave dhe ministrive si dhe mos obligimi për të publikuar shpalljet për subvencione qoftë në uebfaqe zyrtare apo përmes ndonjë mediumi tjetër.

Tjetër gjë me rëndësi është që afatet e shqyrtimit të kërkesave janë të ndryshme në çdo komunë dhe shumica prej tyre as nuk përcaktojnë afate për shqyrtim të ankesave nga përfituesit potencial.

Sa i përket përbërjes së komisioneve vlerësuese, nuk përcaktohet numri i anëtarëve, nuk promovohet përfaqësim i barabartë gjinor e në shumë raste nuk konsiderohet pjesëmarrja nga ekspertë të jashtëm, por vetëm nga zyrtarë komunalë duke minimizuar kështu transparencën në dhënien e subvencioneve.

Gjithashtu, disa nga rregulloret nuk obligojnë institucionet që të krijojnë marrëveshje në mes të përfituesve dhe institucionit ani pse kjo vërehet në praktikë. Për më tepër, as publikimi i emrave të përfituesve me shumat e përfituara nuk kërkohet.

Megjithëse të gjitha rregulloret kanë të përcaktura disa fusha përmes të cilave japin subvencione, kriteret përbrenda fushës shpeshherë më shumë ngjajnë në një nën-kategori sesa në një kriter duke lënë hapësirë për gjykime më shumë subjektive. E përveç kësaj, kufijtë maksimalë për subvencionim nuk janë të caktuar me ndonjë kriter specifik.

Numri i kufizimeve për të njëjtit përfitues brenda periudhës një vjeçare ekziston në disa komuna, por në disa raste nënkuptohet vetëm për

³⁹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, neni 12 <<http://bit.ly/1CulaKA>>

përfituesit e ndihmave shëndetësore e sociale, por kjo nuk është e përcaktuar në hollësi. E disa komuna nuk kanë fare kufizime të tilla duke krijuar hapësirë për koncentrim të subvencioneve.

Problemet kryesore në praktikë janë parë në mos zbatimin e plotë të rregulloreve ku në disa raste nuk janë mbledhur raportimet financiare nga përfituesit për të siguruar se paratë janë shfrytëzuar sipas destinimit; janë miratuar subvencione nga kryetarët edhe në rastet kur është tejkualuar kufiri i shumës maksimale për persona juridik e fizik; kanë përfituar disa herë dhe shpesh të njëjtat subjekte me shumën më të madhe si dhe janë subvencionuar bizneset në rastet kur nuk parashihet me rregullore.

Duke u nisur nga këto të gjetura, Instituti GAP ofron këto rekomandime:

Rekomandimet për përmbajtjen e rregulloreve

- Të kenë definicion uniform të subvencioneve në aspekt financiar dhe kontekstual dhe definicione të veçanta sipas llojit të subvencioneve;
- Të kërkojnë shpalljen e thirrjeve për aplikim për subvencione në uebfaqet zyrtare të institucioneve;
- Të potencohet përbërja e komisionit sipas numrit të anëtarëve, ekspertizës, gjinisë dhe pjesëmarrjes si pjesëtarë të institucionit apo ekspertë të jashtëm dhe në të njëjtën kohë të ekzistojnë komisione që do të trajtonin çështjet në lidhje me keqpërdorimin e subvencioneve apo të bënin matjen e ndikimit ekonomik të subvencioneve të realizuara në sektorë të ndryshëm;
- Të kërkojnë arsyetimin e ndarjes së mjeteve për përfitues individualë, grupe dhe organizata sipas shumës;
- Të përcaktojnë kriteret për kufijtë minimalë dhe maksimalë të ndarjes së subvencioneve;
- Të bëjnë ndarje të qartë në mes të sektorit dhe kriterëve sektoriale – si për shembull për mbjelljet pranverore në fushën e bujqësisë, kriter mund të jetë lloji i pemëve dhe perimeve në mungesë, për pylltari mund të përcaktohen mbjellja e drunjve më të rrezikuar nga dëmet, e të tjera;
- Të krijohen komisione monitoruese për përcjelljen e përfituesve të subvencioneve dhe granteve dhe të caktohet afati i monitorimit për çdo lloj aktiviteti
- Të specifikohen llojet e subvencioneve që mund të jepen përmes zyrës së kryetarit dhe drejtorive tjera;
- Të kërkojnë krijimin e formularëve të veçantë për aplikim sipas fushës dhe llojit të përfituesit dhe publikimin e tyre në uebfaqet zyrtare të institucioneve;
- Të kërkojnë publikimin e emrave të përfituesve dhe shumën e përfituar në uebfaqet zyrtare;

- Të përcaktohet kufiri i përfitimeve nga i njëjti subjekt për secilën kategori.

Rekomandimet për zbatimin e rregulloreve

- Të përdoren uebfaqet zyrtare për shpalljen e thirrjeve, publikimin e përfituesve dhe shumat;
- Të publikohen përshkrimet e projekteve përfituese dhe arsyetimi për subvencionim në uebfaqet zyrtare;
- Të mblidhen raporte financiare dhe narrative nga institucionet, përkatësisht drejtoritë që japin subvencione, për t'u siguruar se subvencionet janë shpenzuar për aktivitetet e parapara;
- Të zbatohet rregulla për miratim të subvencioneve nga kuvendi komunal atëherë kur shuma tejkalon kufirin për të cilin mund të miratojë kryetar-i/ja.

Rekomandime të përgjithshme:

- Rregulloret e brendshme në nivel të Institucioneve të jenë të unifikuara dhe mos të ketë dallime të mëdha nga një institucion në tjetrin;
- Të aprovohet një rregullore nacionale për subvencione, grante dhe donacione duke përfshirë ndarjen për të gjitha llojet e entiteteve dhe kategorive për subvencionim;
- Çdo Organizatë Buxhetore (OB) duhet të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me përfituesit e subvencioneve në përputhje me mundësitë buxhetore dhe në asnjë mënyre nuk duhet lejuar tejkalimi i ndarjeve buxhetore të asaj OB-je.

Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti GAP mbështetet nga:



Ky projekt është mbështetur nga:

